

I – INFORMACION I PERGJITHSHEM DHE POLITIKAT KONTABEL

*Emri Njesise Ekonomike, Selia dhe Forma Ligjore

Shoqëria " LALA " sh.p.k është krijuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me një ortak të vetëm, me Vendim Nr.18847 dt.23.02.1998 të Gjykatës Tiranë.

Me Vendim Nr.18847/1 date 13.12.1999 dhe Nr.18847/2 dt.10.02.2004, shoqëria ka shtuar objektin e veprimtarisë së saj . Me Vendim Nr.18847/4 dt.11.06.2005, Vendim Nr.18847/6 dt.22.05.2006 dhe CN-453284-10-10 është bërë rritja e kapitalit themelart të shoqërisë.

Veprimtaria e shoqërisë "LALA" sh.p.k rregullohet sipas dispozitave përkatëse të Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008, nga statuti i saj dhe legjislacioni në fuqi.

Selia Qendrore në të cilën shoqëria zhvillon aktivitetin e saj sipas Certificate Rregjistrimi të QKR datë 25.07.2008 me NIPT J 76418903 B është me Adrese Kryesore ; KUKËS, Krumë Has.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj edhe në Filialin e Tiranës në ambiente zyra pa qera ne Rruga "BUDI" Nr. 25/3 Tiranë.

*Aktiviteti Kryesor i Njesise Ekonomike

Shoqëria " LALA " sh.p.k ka si objekt veprimtarinë në: " Tregtim me shumicë e pakicë dhe import eksport të mallrave të ndryshem, transport mallra brenda e jashtë vendit; aktivitet në fushën e ndërtimit si : punime dheu; sisteme; taracime terenesh; prodhime materiale ndërtimi; prodhime materiale inertë rërë, çakull , gurë,etj, ndërtime civile dhe ekonomike; ndërtime civile industriale, turistike, bujqesore etj, mbi dy kate dhe kompletim me instalimet e nevojshme; ndërtime rrugore ;ndërtim ujësjellesa e kanalizime; ndërtim vepra kullimi; ujitje toke e impiante vaditëse; rikonstrukcione godinash civile dhe ekonomike; veshje fasadash; punime mirembajtje si dhe zhvillim dekori në mjedise urbane."

Në vitin 2018 shoqëria "LALA" shpk ka ushtruar veprimtarinë në:

Rehabilitim e rikonstrukcione ne ujësjellesa, godina, etj .

Kontributi në shoqëri perfaqesohet nga kapitali i ortakut të vetëm.

*Zbatimi i rregullave të mbajtjes së kontabilitetit

Kontabiliteti është organizuar dhe mbajtur në pajtim me kerkesat e Ligjit Nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit.

Ngjarjet dhe veprimet ekonomike janë rregjistruar në rregjistrat kontabel në mënyrë kronologjike dhe sistematike në programin e administrimit financiar dhe kontabel " BILANC".

Rregjistrimi i veprimeve ekonomike bazohet në Evidencën Mbështetëse.

Veprimet janë ngurtesuar me 31 Dhjetor 2019.

*Politikat Kryesore Kontabel.

Ndërtimi i Pasqyrave Financiare të shoqërisë (Bilanci Kontabel) per vitin 2019 bazohet në Standartet Kombëtare të Kontabilitetit dhe veçanarisht në SKK Nr. 2, në Ligjin Nr. 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare ", Neni 4, pasi shoqëria plotëson kushtet për zbatimin e Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit.

Shifrat e Pasqyrave Financiare të shoqërisë (Bilanci Kontabel) për vitin 2019 janë të krahasueshme me vitin paraardhës, pasi janë zbatuar të njëjtat politika kontabel.

Politikat kontabel të Shoqërisë "LALA" sh.p.k reflektojnë praktikën e këtij aktiviteti.

Mbajtja e Kontabilitetit bëhet nëpërmjet rregjistrimit të veprimeve dhe fakteve ekonomike në ditar dhe llogari ne menyre te kompjuterizuar në programin e administrimit financiar dhe kontabel " BILANC".

Sistemi Kontabel i zbatuar për matjen në llogari, matjen, klasifikimin dhe paraqitjen e të dhënave financiare bazohet mbi të drejtat e konstatuara.

Standarti Kontabel që përcakton parimet dhe rregullat e përgjithshme për tu zbatuar në hartimin e pasqyrave financiare mbështetet në kerkesat e Ligjit Nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Pasqyrat Financiare sigurojnë transparencën dhe të dhënat e nevojshme për vendimmarrje.

Pasqyrat Financiare janë pregatitur bazuar në kontabilitetin ushtrimor dhe në vijueshmërinë e veprimtarisë ekonomike.

Paraqitja dhe klasifikimi i elementeve të pasqyrave financiare është bërë në koherencë në të dy ushtrimet.

Aktivet Agfatgjata Materiale (AAM) paraqiten në bilanc me vlerën neto (koston historike minus amortizimin e akumuluar të llogaritur për kohën e shfrytëzimit të tyre). Shpenzimet e amortizimit për vitin 2019 janë brenda normave të lejuara nga Ligji Nr. 8438 datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të Ardhurat".

Egzistenca dhe vlerësimi i aktiveve vërtetohet nga dokumentacioni bazë që përmban rregjistrimet fillestare për aktivet dhe nga rregjistrat kontabel në të cilat është bërë rregjistrimi i aktiveve. Aktivet janë të inventarizuara sipas klasifikimit në kontabilitet.

Egzistenca dhe vlerësimi i detyrimeve vërtetohet nga dokumentacioni bazë që përmban rregjistrimet fillestare të detyrimeve dhe nga rregjistrat kontabel. Detyrimet janë të inventarizuara.

Inventaret paraqiten në formë materiale dhe furnizimesh për tu perdorur në procesin e kryerjes së shpenzimeve.

Inventari vlerësohet me koston e blerjes.

Shpenzimet janë kontabilizuar në bazë të dokumentit bazë të shpenzimeve.

Të ardhurat nga shitja janë kontabilizuar në bazë të faturave tatimore të shitjes.

II – SHPJEGIME TË ZËRAVE TË PASQYRAVE FINANCIARE (BILANCI KONTABEL)

Pasqyrat Financiare të vitit 2019 (BILANCI KONTABEL) janë hartuar sipas formatit të përcaktuar në Standartin Kombëtar të Kontabilitetit Nr. 2.

Çelja e llogarive të vitit 2019 rakordon me mbylljen e llogarive të vitit 2018.

Grupet dhe postet për ushtrimin e mbyllur 2019 dhe ushtrimin paraardhës 2018 rezultojnë si më poshtë:

AKTIVI

Totali i AKTIVIT ne ushtrimin e mbyllur 2019 rezulton me Vlere Neto 376,552,522 leke.

Aktivitet e shoqërisë përfaqësohen nga:

I - AKTIVE AFATSHKURTËRA me Vlere Neto 90,279,187 Leke.

Aktivitet Afatshkurtëra përfaqësohen nga:

I.a - Mjetet Monetare me 9,773,540 leke.

Gjendja e Mjeteve Monetare në 31.12.2019 e krabasuar paraqitet:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018	Ndryshimi +/-
Para në Arkë	5.325.332	20,632	5.304.700
Para në Bankë	4.448.208	653,720	3,794,488
Totali	9.773.540	674,352	9,099,188

I.b - Aktive të tjera financiare afatshkurtëra me vlerë 103,743,465 leke përfaqësohen nga:

-Detyrimet e klientëve ndaj shoqërisë për shitje shtesimesh për faturat e papaguara deri në datë 31.12.2019 në vlerën 78,629,282 leke, Ortaku 380,901 leke, Tatim Fitimi i paraguat 747,732 leke, Parapagimet ne shumen 23,985,550 leke. Në datë 31.12.2019 klientet nuk kanë detyrime në monedhe të huaj ndaj shoqërisë. Për pasojë shoqëria nuk ka krijuar diferenca konvertimi (shpenzime ose të ardhura) nga konvertimi i detyrimit në monedhe të huaj me kursin në leke të monedhes së huaj në datë 31.12.2019.

Gjendja e Kërkesave të Arketueshme në 31.12.2019 e krabasuar paraqitet:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018	Ndryshimi +/-
Kliente	78,629,282	125,835,932	(47,207,514)
Ortaku	380,901	0	(380,901)
Parapagime	23,985,550	43,874,464	(19,888,914)
Totali	169,724,831	169,724,831	(65,981,366)

I.c - Inventari me vlerë kontabile i paraqitur 31.12.2019 për 175,836,254 leke.

Gjendja e Inventarit ne 31.12.2019 e krabasuar paraqitet:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018	Ndryshimi +/-
Materiale te para	243,713,787	175,836,254	67,877,533

III – AKTIVE AFATGJATA me Vlere Neto 19,321,731 leke përfaqësohen nga:

III.a - Aktive afatgjata materiale me vlerë neto 19,321,731 leke

Gjendja e Aktiveve Afatgjata Materiale ne 31.12.2019 e krabasuar paraqitet:

Aktive te trupezuara	Mjete Transporti	Pajisje Zyra, Informatike	Totali
Vlera fillestare	39,862,209	4,332,694	44,194,903
Shtesa	1,278,160	1,294,452	2,572,613
Paketime	-300,000		-300,000
Amortizimi shtese	-23,415,389	-2,201,305	-25,616,694
Gjendja Pa Amortizim 31.12.2019	17,424,980	3,425,841	20,850,822
Amortizimi 2019	-1,417,111	-111,976	-1,529,087
Gjendja 31.12.2019	16,007,869	3,313,865	19,321,731

DETYRIMET dhe KAPITALI

Totali i Detyrimeve dhe Kapitalit të shoqërisë në ushtrimin e mbyllur 2019 rezultojnë me Vlerë Neto 376,552,522 leke.

Detyrimet dhe Kapitali i shoqërisë përfaqësohen nga:

I - DETYRIME AFATSHKURTERA me Vlerë Neto 255,742,960 leke, që përfaqësohen nga:

a - *Huamarrje afatshkurtera* me vlerë 128,090,341 leke, që përfaqësojnë detyrimin e shoqërisë për shlyerje të principalit të huasë në datën 31.12.2019 (llogaria e huasë Over Drafft & Hua).

Gjendja e Huasë Bankare në 31.12.2018 e krahasuar paraqitet:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018	Ndryshimi +/-
Hua Banka/(O).Drafft	126,722,541	132,367,699	(5,645,158)
Hua Te tjera	1,367,800	1,367,800	0
Totali	128,090,341	133,735,499	(5,645,158)

b - *Të pagueshme ndaj furnitorëve* me vlerë 117,347,578 leke, përfaqësojnë detyrimin për furnizimet e mbërritura nga furnitorët por të papaguara nga shoqëria deri me datë 31.12.2019. Në datë 31.12.2019 shoqëria nuk ka detyrim ndaj furnitorëve në monedhë të huaj dhe për pasojë nuk ka krijuar diferencë konvertimi (shpenzime ose të ardhura) nga konvertimi i detyrimit në monedhë të huaj me kursin në leke të monedhës së huaj në datë 31.12.2019.

Gjendja e Detyrimeve ndaj Furnitorëve në 31.12.2019 e krahasuar paraqitet:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018	Ndryshimi +/-
Furnitorët	117,348,578	101,567,953	15,780,625

c - Detyrimet e Tatimeve & Punonjësve në shumën 10,304,042 leke përbëhet si:

Të pagueshme ndaj punonjësve në vlerë 8,154,142 leke, Detyrimin për kontribute dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore për shumën 1,126,444 leke deri në 31.12.2019, *I.c.1 - Tatim mbi ardhurat* në vlerë 139,534 leke, deri 31.12.2019, *I.c.2 - Tatim mbi vlerën e shtuar* në 883,922 leke, deri 31.12.2019, *I.c.3 - Ortaku* në vlerë 0 leke, Përfaqësojnë detyrimin e ortakut deri 31.12.2019.

Gjendja e Detyrimeve në 31.12.2019 e krahasuar paraqitet:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018	Ndryshimi +/-
Pagat e punonjësve	8,154,142	2,902,432	5,251,710
Sig shoqërore	1,126,444	511,951	614,494
Tatim mbi të Ardhurat	139,534	64,271	74,813
Tatim Fitimi - Detyrim	0	0	0
TVSH - Detyrim	883,922	6,260,268	(5,376,346)
Ortaku - Detyrim	0	5,095,178	(5,095,178)
Totali	14,834,550	14,834,550	(4,530,507)

II - KAPITALI në Vlerë Neto 120,809,563 Leke

Kapitali i shoqërisë në vitin 2019 paraqitet në shumën 120,809,563 leke.

* Kapitali aksioner me vlerë 55,372,954 leke.

* Rezervat me vlerë 514,452 leke

Përfaqësojnë rezervat e krijuara nga fitimet e shoqërisë sipas normave ligjore.

Rezervat e shoqërisë detajohen në:

-Rezerva Ligjore	154,335	leke
-Rezerva Statutore	360,177	leke
* Rezerva e Tjera	61,284,805	leke
* Fitimi i vitit financiar	3,637,351	leke

Përfaqëson rezultatin sipas PASH për vitin 2019.

III - INFORMACION SHPJEGUES PËR PASH-in.

Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve është përgatitur sipas Formatit Nr. 1 të përcaktuar në SKK Nr. 2

Të ardhurat nga shitja përfaqësohen të ardhurat e faturuara nga librat e shitjeve mbi bazë të situacioneve të punimeve sipas kontratave të sipërmarrjeve në ndërtim dhe diferencave pozitive nga kursi i këmbimit.

Të ardhurat e vitit 2019 detajohen:

Emertimi	Shuma	Monedha
<u>Të ardhura të Tatueshme</u>	<u>111,958,772</u>	<u>leke</u>
<u>Të ardhura nga kursi i këmbimeve</u>	<u>40,144</u>	<u>"</u>
<u>TOTALI</u>	<u>111,998,916</u>	<u>"</u>

Shpenzimet e paraqitura në PASH dhe kryesisht shpenzimet e blerjeve të materialeve të para, punime dhe blerje furniturash nga të tretët janë shpenzime të rregjistruara sipas faturave tatimore bazuar në emimin e blerjes. Shpenzimet për pagesat në monedhë të huaj përfaqësojnë fondin e pagave për vitin 2019. Shpenzimet për të tjera përfaqësojnë punimet e kryera me nënkontingjentin e vitit 2019. Shpenzimet për

SHËNIME SHPJEGUESE PËR PASQYRAT FINANCIARE

Periudha 1 Janar – 31 Dhjetor 2019

Shoqëria " LALA " SH.P.K KUKËS, Krumë, Has.

Amortizim përfaqëson amortizimin e asetëve për vitin 2019. Shpenzimet për interesa përfaqësojnë interesat e paguara nga shoqëria në vitin 2019 për përdorim Hua bankatë (Owendraft). Shpenzimet financiare përfaqësojnë gjoha dhe demshperblime, humbje të ndryshme të shoqërisë, Shpenzime qeraje

Shpenzimet kryesore për vitin 2019 detajohen :

<u>Emertimi</u>	<u>Shuma</u>	<u>Monedha</u>
Shpenzime për blerjen e lëndëve të para dhe furnitura	59,662,659	leke
Shpenzime për personelin	27,575,100	"
Shpenzime amortizimi	1,529,087	"
Shpenzime të tjera financiare	10,901,374	"
Shpenzime për interesa	7,782,077	"
TOTALI	107,410,153	"

REZULTATI TË ARDHURA & SHPENZIME TATIMORE

	<u>TË USHTRIMIT</u>	<u>TATIMORE</u>
Te Ardhurat nga shitjet	111,958,772	111,958,772
Të ardhurat nga Kurset e Këmbimit	40,144	40,144
Shpenzime të panjohura për efekte fiskale		
TOTALI I TË ARDHURAVE	111,998,916	111,998,916
TOTALI I SHPENZIMEVE	107,410,153	107,410,153
FITIMI PARA TATIMIT	4,588,763	4,588,763
NORMA E TATIMIT MBI FITIMIN 15 %	682,293	682,293
NORMA E TATIMIT MBI FITIMIN 15 % shpenzimet e panjohura	228,975	228,975
FITIMI NETO	3,637,351	3,637,351

Shpenzimet e pazbritshme janë për pagat e personelit 1,526,500 leke për të cilat janë likuiduar me arke, dhe sipas Ligjit Nr. 9766 datë 09.07.2007 "Për Tatimin mbi të Ardhurat". Për këtë arsye këto shpenzime të cilat janë kryer me arkë janë marrë si shpenzime të panjohura për efekte fiskale.

IV - INFORMACION SHPJEGUES PËR FLUKSIN MONETAR

Pasqyra e Fluksit Monetar të vitit 2019 është përgatitur sipas formatit të përcaktuar në SKK Nr. 2, Metoda Indirekte. Sipas Pasqyrës së Fluksit të Parasë të vitit 2019 shoqëria paraqitet me rritje monetare prej 9,099,188 leke.

V - INFORMACION SHPJEGUES PËR PASQYREN E LËVIZJES KAPITALIT

Pasqyra e Lëvizjes së kapitalit është përgatitur sipas formatit të përcaktuar në SKK Nr. 2. Sipas Pasqyrës së Lëvizjes së Kapitalit të vitit 2019 kapitali shoqërisë rezulton me rritje në shumën 3,637,351 leke dhe totali neto i Kapitalit shon në shumën 120,809,563 leke.

ADMINISTRATORI

Skënder LALA



Kontabilisti

Jonuz Lala

